



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.229/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në Prishtinë, për shkak të vendosjes së afisheve në tabelën e njoftimit publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, kështu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 950 (nëntëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 06.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në Prishtinë, me të cilën pretendon se aktivist të LVV, në Rrugën “Nazim Gafurri” në vendin e caktuar për njoftime publike, kanë vendosur afishe për njoftim në hapësirën e destinuar për njoftime publike nga komuna.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e nenit 4. 1 pika b të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 dhe 3.4 i rregullës 13/2014 vendosja materialeve zgjedhore në hapësirat publike përmban veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, me datë 06.06.2014 e informoi subjektin politik Lëvizje Vetëvendosje (LVV), për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë, dhe i ka dhënë Urdhër për të Ndërmarr masat Përmirësuese lidhur me aneksen deri në datë 07.06.2014 në ora 19.00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LVV në të cilën deklaroi se shtabi zgjedhor i LVV në Prishtinë ka ndërmarr të gjitha masat përmirësuese me ç'rast aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) posa kanë kuptuar për vendosjen e njoftimit për tubim të njëjtit i kanë hjekur nga vendi ku aludohet se janë ngjitur. Përgjigjes në ankesë ia kanë bashkangjitur edhe fotografitë nga vendi ku janë ndërmarrë masat përmirësuese sipas urdhrit të PZAP-it.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se në tabelën e njoftimeve publike - harta e qytetit të Prishtinës është mbuluar me njoftimin e subjektit politik LVV me të cilin i fton qytetarët për tubim të këtij subjekti për promovimin e programit propagandues për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila dispozitë përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakateve dhe posterave, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave* ”

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rëndësuese mori se subjekti politik LVV ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik LVV, pas marrjes së kërkesës së PZAP-it për përgjigje në ankesë dhe Urdhërit për të Ndërmarr Masa Përmirësuese, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke

larguar menjëherë njoftimin e tyre nga tabela e njoftimeve të objektit të Kuvendit Komunal të Prishtinës.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik LVV është shkelur neni 33 pika b) të LZP-së, pasi që slogani i subjektit në fjalë është mbishkruar në tabelën e Komunës, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik LVV që ka ndërmarrë për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të disa fotografive të cilat i ka ofruar si prove të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 229/2014 më datën 08.06.2014.

Kryesuesi i Panelit



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*